

STATUT

I SHOQËRISE MERKA KSAMIL SHPK

Sot ne dt.28 Korrik 2020 me cilesine e "Ortakove Themelues":

PËRPARIM MERKA, i biri i Qazim(it) i datelindjes 17-02-1966, i lindur ne Sinanaj, Tepelene dhe banues Sarande,fshati Manastir, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.034870415 ,leshuar nga MB Tirane me date 07/10/2019,

FETA MERKA, i biri i Qazim(it) i datelindjes 21-04-1963, i lindur ne Sinanaj, Tepelene dhe banues Sarande,fshati Manastir, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.034982278 leshuar nga MB Tirane me date 31/10/2019,

te cilet me vullnet të lire të plete e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me emertimin **MERKA KSAMIL shpk.**

KREU I

Krijimi,Personaliteti juridik,Selia

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **MERKA KSAMIL shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria **MERKA KSAMIL shpk**, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Sarande,fshati Manastir,plazhi "Pasqyra", godine nje kateshe,zk 2297

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Ortakut.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Kafe-Restoran-stacion plazhi,sherbime turistike.
- Importin , eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te artikujve te ndyshem industriale , ushqimore , produkteve te ndryshme buqesore , blegtorale e fruta perime , prodhimeve te detit , pije freskuese , te miellit e nenprodukteve te tij , te konfekSIONeve e veshmbathjeve , pajisje elektroshtepiake ,kompjutera dhe pjeset e tjera te tyre , produkte higjenosanitare , hidraulike , prodhime keramike artizanati, duralumini , mekanike te lendet drusore te perpunuar dhe te paperpunuar, lekures e nenprodukteve te saj , mobiljeve dhe materialeve te lendeve te para te te gjitha llojeve ,



materiale dhe lendeve te ndertimit , pllakat e llojeve dhe dimensioneve te ndryshme , materialeve plastike e nenprodukteve te tyre.

- Transport kombetar dhe nderkombetar tokesor te udhetareve, bagazheve dhe mallrave.
- Hapje fabrikash , ndertime hecesh ,prodhim dhe shitje energjie, hapje spitalesh, hapje te depove farmaceutike etj.
- Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajteshme dhe te paluajteshme, pjesemarrje me kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqipetar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues:**PËRPARIM MERKA**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te perjithshme 50.000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **FETA MERKA**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te perjithshme 50.000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **100.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **100.000 Leke**, eshte paguar nga ne ortaket.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim te Asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabel të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpresa datës së mbledhjes së Asamblese se ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrrohet në një formë tjeter. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per to rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar to shoqerise. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjesave te kapitalit qe perfaqesojne.

Vendimi lidhur me kapitalin i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim nga administratori ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 date 03.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".



Neni 8
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me pelqimin e te dy ortakeve te shoqerise dhe me kushte jo me te favorshme se ato me te cilat u jane ofruar ortakeve te tjere me pare.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organë Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e me poshtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhc "d" to kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese se ortakeve dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne ushtrimin e se drejtes se tyre per te marre pjese ne vendimet kolektive cdo ortak ka te drejte te parfaqesohet nga nje ortak tjeter ose nga nje person i zgjedhur prej tij.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje to asamblese se per gjithshme e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Asambleja e ortakeve mund te thirret nga secili ortak, nga administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likuiduesi.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 10

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepernjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjes e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 to ketij nen, ajo mund to marre vendime te vlefshme veterne te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullisise.

Neni 11

Kuorumi

- a) Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
- b) Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet to vendose per ceshtje, to cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 to ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mund to marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 to ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise, shnderimin ne nje forme tjeter, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqerise, zhvillon mbledhje te jashtezakonshme, te cilat jane te vlefshme kur ne te jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave te kapitalit te shoqerise te cilet votojne me shkrese apo mjete elektronike, sipas parashikimeve to pikes 3 to nenit 88 te ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesemarres.

Asambleja e pergjithshme vodos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, kur ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote te cilet zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e Iikuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve to ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

Neni 13

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakeve.

The image shows two handwritten signatures in black ink. The signature on the left appears to be 'Rex.' and the one on the right appears to be 'Loy'.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 14
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te perbashket te cilet do ti kryejne te gjitha funksjonet e administrimit te shoqerise bashkarisht duke nenshkruar ne te bashkarisht çfaredo lloj dokumenti qe lidhet me administrimin dhe funksjonimin normal te aktivitetit e shoqerise.

Administratorret e shoqerise jane ortaket e saj **Z.PËRPARIM MERKA dhe Z.FETA MERKA** me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratorret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorret ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratorret shkarkohen nga gjykata per shkeje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Neni 15
Kompetencat

Administratori/et ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori/et angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratori/eve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e Administratori/eve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori/eve ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhëniet si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Administratori/et ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje to gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;



g) raportoje perpara Asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori/et eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve to ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori/et ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem. Administratori/et perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo to huaja, perfshi ketu autoritetet gjiqesore te te gjitha shkallevet, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori/et ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per to kryer derdhje, terheqje, transferta etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave to Punes, Autoriteteteve Doganore etj, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Neni 16

Pergjegjesite

Administratori/et eshte (jane) pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojet e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin deme shoqerise i ngarkohen administratorit/eve dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 e 18 to ligjt "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare" administrator/et detyrohet:

1.

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ato te shoqerise;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori/et, gjate kryerjes se detyrave te tij per gjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administrator/et vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me te kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara.

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne te, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara nese ne kundershtim



me dispozitat e ligjit , Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) a paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet e shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per to shlyer detyrimet
- e) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e pote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Neni 17

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimi, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 18

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblese se ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financier, sic edhe parashikohet nga ligji.

Neni 19

Eksperet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Asamblese se ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 20

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asambleja e ortakeve, e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibiliteten e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Neni 21

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 22

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar sic mund te jene
a. Humbja e kapitalit ose pamundesa e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.
b. Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.
Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 23

Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqerie ekzistuese ose një shoqerie të re që ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaket e shoqerise, që bëjne kalimin e trashëgimisë së shoqerise në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfitojne pjesë të kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqërítë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqerise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqërítë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 24

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 25

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debitore qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 26

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil,Ligjin per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 27

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 28

Dispozita perfundimtare

Ky statut hartohet dhe nenshkruehet ne tre kopje me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe, pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga ne Ortaket themelues te shoqerise tregtare **MERKA KSAMIL shpk**, nenshkruehet ne te gjitha kopjet.

Ky statut hyn ne fuqi menjehere pas regjistrimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

ORTAKET

Terparim Merka


Feta Merka
